



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 2635 Prot.

Tiranë, më 24 05 .2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1627/1 PROT, DATË 05.06.2025 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË
ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASIT Z. ZEF
NDOKAJ, ZNJ. MAJLINDA NDOKAJ DHE ZNJ. ERSUELA NDOKAJ”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Zef Ndokaj, znj. Majlinda Ndokaj dhe znj. Ersuela Ndokaj, me nr. 1103 prot., datë 27.04.2022 dhe nr. 1103/1 prot., datë 27.04.2022, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratit G.J., me detyrë gjyqtar pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, Shkodër, në kohën kur shkëlja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin 1627/1 prot, datë 05.06.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasit z. Zef Ndokaj, znj. Majlinda Ndokaj dhe znj. Ersuela Ndokaj”, bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Myslym Shyri”, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko